



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA IV

Sesioni pranveror

Komisioni për Integrime Evropiane

Mbledhja nr. 7

Prishtinë, më 11.05.2011, në orën 10:30

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-301

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR INTEGRIME EVROPIANE

Në mbledhje morën pjesë: Lutfi Haziri, Blerta Deliu - Kodra, Vjosa Osmani, Alma Lama, Suzana Novobërdali dhe Albert Kinolli.

Munguan: Xhavit Haliti, Sasha Milosavljeviq, Fatmir Limaj, Blerim Shala dhe Nekibe Kelmendi.

Të pranishmit nga delegacioni Holandez : Gerda Verburg- Kryetare e Komisionit Parlamentar për Çështje Evropiane, Harry van Bommel- Zv.kryetar, Louis Bontes, Henk Jan Ormel, Han ten Broeke, Gerard Schouë, Pierre Heijnen, Joop Nijssen, Robert Bosch- Ambasador i Holandës në Kosovë, Emma Kay, dhe Carel Brands.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Ahtere Loxha – koordinatorë dhe Pajtim Gashi - praktikant.

Pjesëmarrës të tjerë: Përfaqësuesit nga OSBE-ja, Ambasada Britanike dhe Zyra Ndërlidhëse e Komisionit Evropian.

Mbledhjen e kryesoi Lutfi Haziri – kryetar i Komisionit.

R E N D I I D I T Ë S

1. Takim me Komisionin parlamentar Holandez për Çështje Evropiane.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e takimit dhe hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Takim me Komisionin parlamentar Holandez për Çështje Evropiane.

Kryesuesi – pasi tha fjalën përshëndetëse prezantoi anëtarët e komisionit dhe shtjelloi se komisioni ynë mbulon kryesisht agjendën për Integrim Evropian. Kuvendi i Kosovës vetëm disa javë më herët ka miratuar Planin e Veprimit që përfshinë angazhimet e Kosovës për arritjen e një progresi më të madh. Agjenda e Integritimit është agjendë e cila nuk na dallon në komision dhe që ka konsensus të plotë politik si nga pozita po ashtu edhe nga opozita. Problemi kryesorë për Kosovën mbetet edhe më tej pa qartësi për rrugën e Integritimit Evropian dhe po ashtu mos qartësia edhe për procesin e liberalizimit të vizave, ku vetëm Kosova nga i tërë rajoni ka pa qartësi për këtë aspekt dhe përbënë një aspekt shqetësues për ne.

Gerda Verburg - Kryetarja e Komisionit Holandez për Çështje Evropiane - tha se ne me kënaqësi po presim të kemi një shkëmbim mendimesh të qarta për çështjet e Integritimit Evropian. Ne erdhëm nga Holanda në një vizitë fakt mbledhëse në Kosovë, Serbi dhe Shqipëri. Ndërsa këtu në Kosovë pas 3 viteve demokraci ne kemi ardhur të gatshëm të kuptojmë drejt se si po shkojnë gjërat dhe të shkëmbejmë mendimet tona me Kuvendin e Kosovës sa i përket Integritimit Evropian.

Pierre Heijnen - tha se është përfaqësues në këtë komision i partisë e cila në zgjedhjet e fundit doli e dyta në Holandë dhe që tani gjendet në opozitë, dhe shtroi pyetjen: Ju po ndërtoni punën e Kuvendit dhe a do të doni të kishit më shumë instrumente, përgjegjësi dhe buxhet për të ndarë posaçërisht do ndërlidhesha me procesin e decentralizimit ku do të doja të dija mundësitë për qeveritë lokale të decentralizuara. Si ju do të zhvilloni decentralizimin që komunat të marrin vendimet e tyre dhe të shpenzojnë buxhetin e tyre, pra ndoshta në këtë rrafsh mund të na tregoni diçka më shumë?

Vjosa Osmani u përgjigj duke thënë se procesi i decentralizimit ka qenë një proces i rëndësishëm i para parë me Pakon e Ahtisarit. Ndërsa deri me tani Institucionet e Kosovës kanë qenë mjaft të përkushtuara dhe të suksesshme në këtë aspekt posaçërisht në caktimin e përgjegjësive në nivelin Komunal. Pra duke menduar se ka pasur progres ne edhe si parti politike kemi ngritur zërin tonë fuqimisht që ky proces të dalë i suksesshëm. Suksemi i madh i Institucioneve kosovare është themelimi i Komunave me shumicë minoritare ku ne sot kemi bashkëpunim me shumicën e këtyre komunave por kemi nevojë ende për mbështetje të mëtutjeshme ekonomike për këto komuna të reja për zhvillimin e tyre. Dispozitat e Ahtisarit janë të përfshira edhe në Kushtetutë dhe shumica e tyre deri tani janë zbatuar dhe në këtë proces besoj se kemi qenë mjaft të suksesshëm. Meqë jemi te komunat dua të theksoj po ashtu se ne si komision kemi bashkëpunim edhe me Ministrinë e Integritimit ku tani jemi duke bërë përpjekje për riintegrimin e të riatëdhësuarve të kthyer në komunat e tyre.

Han ten Broeke tha se dëshiron të ngritë në diskutim çështjen e liberalizimit të vizave. Zt. Haziri përmendi çështjen e një getoje për Kosovën. Unë nuk mendoj ashtu dhe dëshiroj të them atë që kam mësuar edhe nga filmat amerikan se e vetmja mënyrë për të dalë nga geto-ja është që ju vetë të ngriteni dhe të liroheni nga ajo. Sikur që ishim hezitues për shumicën e rajonit të Ballkanit duhet të them se jemi dhe për Kosovën po ashtu meqë ekzistojnë dhe janë disa standarde evropiane për tu plotësuar si lufta ndaj trafikimit të qenieve njerëzore, drogës, korrupsionit etj, pra a i keni parasysh këto probleme prezentë në vendin tuaj kur bëni këto kërkesa.

Alma Lama tha se fillimisht dëshiron të ndërlidhet me pyetjen e parë meqë unë përfaqësoj partinë që është kundër decentralizimit në baza etnike sepse mendoj që shkakton ndarje të komuniteteve në Kosovë dhe do të shkaktonte edhe ndarjen e Kosovës po ashtu. Prandaj mendoj se është koha tani të shohim nëse Pakoja e Ahtisarit ka pasur sukses dhe a është zbatuar si duhet. Do të shohim se ajo nuk është zbatuar në tërë Kosovën dhe Institucionet e

Kosovës kanë dështuar gjithë këto vite. Ndërsa për pyetjen e dytë e cila kishte të bënte me liberalizimin e vizave dhe me faktin se këtu ka shumë probleme me krimin e organizuar dhe korrupsionin, më lejoni të theksoj se Kosova nuk dallon shumë nga vendet e rajonit. Mendoj se ky është një imazh i keq i krijuar për Kosovën gjithë këto vite dhe se pjesa më e madhe e para gjykimeve vjen nga politikanët evropian mbi këto çështje sepse nuk ka të dhëna të sakta dhe të sigurt se Kosova është realisht ndryshe. Ne kemi këtu shumë misione ndërkombëtare ku shumica kanë ardhur të kujdesen dhe të merren me këto çështje, prandaj konsideroj se nëse dikush duhet të na kritikojë atëherë edhe ndërkombëtarët që janë në Kosovë duhet të marrin përgjegjësinë për këto fenomene. Megjithatë mendoj se Kosova e ka kaluar shumë mirë procesin transitör dhe qytetarët e Kosovës meritojnë të udhëtojnë të lirë në Evropë.

Kryesuesi theksoi se në kohën ish komuniste ne kemi jetuar pa regjim të vizave dhe ne i dimë rregullat, e dimë dhe njohim po ashtu edhe tregun e punës. Sigurisht që kemi pasur shumë probleme gjatë regjimit ku shumë të rinj të përndjekur janë larguar nga Kosova për shkak të politikave diskriminuese. Edukimi është shumë i rëndësishëm dhe ne kemi nevojë për një edukim cilësorë. Kemi një popullsi ku shumica është e moshës mesatare 26 vjeç dhe të cilët nuk kanë shkuar më larg se në Podgoricë, Shkup apo Tiranë, pra Shqiptarët etnik dhe serbët janë të kufizuar të kenë një arsim, edukim dhe jetë më të mirë. Është e vërtetë se kemi probleme me krimin e organizuar, trafikimin e qenieve njerëzore dhe korrupsionin por çka me Bukureshtin që është anëtarë i BE-së kur as ata nuk qëndrojnë më mirë se ne. Ne nuk po kërkojmë Brukselin si diçka shumë të nevojshme por si aspiratë.

Vjosa Osmani - konstatoi se është e rëndësishme për ne që të bëjmë dallimin mes procesit si të tillë dhe arritjes së liberalizimit të vizave si synim. Kosovës jo vetëm që po i mohohet liberalizimi i vizave por edhe procesi integritetit njëkohësisht. Pra neve deri tani na u është mohuar harta rrugore apo strategjia për liberalizimin e vizave që do i jepej Kosovës për tu implementuar. Në anën tjetër besoj se është diçka e pa fat për studentët dhe bizneset kosovare që po duhet trajtuar si kriminelë kur aplikojnë për viza për në vendet anëtare të BE-së. Unë jam profesore në fakultet po ashtu dhe dëshiroj të ju informoj se studentët e mi këto ditë fituan një garë ndërkombëtare të Fakulteteve Juridike të botës duke mundur edhe universitetet më prestigjioze të botës. Ndërsa ne gjatë kësaj periudhe kemi pasur mëdyshje se a do të marrim vizat apo jo. Unë besoj se në veçanti njerëzit që dëshmojnë që udhëtojnë për studime, biznese apo qëllime të tjera zyrtare nuk duhet trajtuar në kategori të njëjtë. Nëse asnjë kategori tjetër nuk do të dallohet nga kriminelët duke pritur deri sa krimi të zhduket në Kosovë atëherë mendoj se ai nuk do të zhduket kurrë. Kurse sa i përket krahasimeve besoj se në shumë aspekte qëndrojmë më mirë se rajoni.

Han ten Broeke – vazhdoi përsëri duke thënë se kemi pasur një keqkuptim meqë është parlamenti ai që ka kërkuar për kufizimin dhe rregullat strikte për vizat përgjithësisht dhe mos e keqkuptoni këtë se ne do të kufizojmë procesin edhe për ju. Ne nuk është se jemi plotësisht kundër këtij procesi.

Luis Bontes – tregoi se është anëtarë i Partisë Liberale dhe shprehu qëndrimin e partisë së tij se janë kundër zgjerimit të mëtutjeshëm të Bashkimit Evropian. Ne si parti jemi kundër hyrjes në Union edhe për Islandën, Kroacinë, Shqipërinë etj. Jemi kundër edhe për Liberalizimin e Vizave jo vetëm për ju por edhe për Shqipërinë e Bosnjën. Ne kemi votuar kundër por është keq se nuk kemi pasur shumicën në parlament për të na mbështetur në këtë proces. Dje kam qenë në Mitrovicë ku ka pasur shumë ankesa ndaj EULEX-it se ata nuk kanë pasur performancë të mirë në Kosovë, prandaj duhet të them se jam shumë i shqetësuar për këtë problem dhe mendimi im është se duhet të ndalim punën e EULEX-it dhe ta nxjerrim atë jashtë, por çfarë do të ndodhë me shtetin tuaj pastaj?

Kryesuesi theksoi se ne respektojmë qëndrimin tuaj sa i përket EULEX-it, por ne kemi menduar se na duhet një organizatë evropiane për të na mbështetur në fushën e drejtësisë. Tani

ata janë ende në procesin e organizimit. EULEX-i nuk është në nivel të duhur në tërë Kosovën. Ata duhet të luftojnë krimin në Kosovë në bashkëpunim të plotë me autoritetet kosovare dhe të zbatojnë ligjin në Kosovë. Pra ne na duhet EULEX-i të na monitorojë por jo edhe të zbatojë ligjin në emër tonë. Ne gjithashtu kemi edhe parti që janë plotësisht kundër EULEX-it si ajo e zonjës Lama.

Alma Lama – u ri-inkuadrua në diskutim duke thënë se ne nuk jemi parti por lëvizje, thjesht nuk dëshirojmë të referohemi si parti. Kurse sa i përket EULEX-it ky është misioni i dytë në Kosovë pas UNMIK-ut ndërsa unë vërejë se problemet këtu janë juridike dhe praktike. Juridike sepse kanë ardhur këtu përmes Rezolutës për Kosovën 1244 e cila nuk pranon pavarësinë tonë e që po ka sjellë shumë telashe. Ndërsa praktike është sepse një pjesë e madhe e stafit të EULEX-it janë të njëjtit njerëz që kanë punuar dikur edhe në UNMIK. Ky mision në punën e vet ka dështuar. Pra mund të paramendoni ardhjen e një prokurori me një mandat 6 mujorë të luftojë krimin në Kosovë. EULEX-i është duke dështuar edhe për luftën e korrupsionit dhe krimit në Kosovë sepse po luanë një rol politik meqë gjatë tërë kohës janë duke pyetur Beogradin se çfarë të bëjnë për shumë gjëra në Kosovë. Nuk mund të pyetën politikanët se a duhet arrestuar një person apo jo. Kosovës i duhen më shumë policë, prokurorë e gjyqtarë të vërtetë që nuk varen nga politika por që si mision kanë sundimin e ligjit. Gjithashtu mendoj se ne nuk na duhet imuniteti sepse në fazën e tranzicionit siç ndodhemi ne nuk duhet të ketë askush imunitet në Kosovë.

Harry Bromand – përfaqësues nga Partia Socialiste tha se si parti në Holandë kanë kundërshtuar pavarësinë e Kosovës për shkak të Rezolutës së UNMIK-ut që është në fuqi. Çfarë ndikimi ka kjo në popullatën e Kosovës nëse e tërë bota vjen në Kosovë për të ju ndihmuar dhe mbështetur?

Henk Jan Ormel pyeti për rolin e deputetëve që kanë në shoqërinë kosovare duke thënë se deputetët duhet të jenë shembull jo vetëm për Kosovën por edhe më gjerë. Pse nuk keni një listë transparente të aktivitetit tuaj financiarë që do ishte mirë të ja shpalosni jo vetëm popullit tuaj por edhe ndërkombëtarëve.

Vjosa Osmani – tha se sa i përket pyetjes së parë pajtohem me ju se ka vështirësi në këtë aspekt. Dua të theksoj se kam qenë koordinatorë e ekipit tonë në Gjykatën e Drejtësisë dhe nga perspektiva ligjore pavarësia e Kosovës nuk është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare. Por tani nuk do të flasë për UNMIK-un por për EULEX-in të cilin ne e kemi vlerësuar shumë në fillim. Arsyeja pse ne e kemi kërkuar EULEX-in ishte që Evropa të na ndihmojë për të sjellë standardet që po i kemi vështirë ti bëjmë ne, megjithëse ka shumë zhgënjim posaçërisht për EULEX-in në veri ku kemi pritur më shumë. Ne kemi një agjenci kundër korrupsionit që ka informacione për të gjithë politikanët dhe për pasurinë e tyre, të cilat janë transparente sepse publikohen.

Albert Kinolli – tha se për sa i përket Integritetit në BE ju njoftoj se komuniteti rom i ka përfaqësuesit e tij në institucionet e Kosovës nga niveli lokal e deri te ai shtetërorë. Gjithashtu dua të pohoj se si shtet i ri e demokratik Kosova ka krijuar një klimë shumë të mirë për afirmimin e minoriteteve.

Alma Lama – në fund tha se e vlerëson vizitën e delegacionit dhe sugjerimet e tyre. Dhe tha se do ti përgjigjem pyetjes së zotit Broman. Transparenca është shumë e rëndësishme për ne, dhe ne jemi pjesë e saj mirëpo kur flitet për këtë atëherë është Qeveria ajo që ka më së shumti probleme me aspektin e transparencës.

Blerta Deliu – theksoi se beson që ky shkëmbim i përvojave do të na shërbejë edhe neve të kemi një qasje më të mirë për këto procese. Për mua ka qenë privilegj dhe nder të jem pjesë e njërit nga komisionet më të rëndësishme. Nuk dua të lë pa përmendur këtu edhe punën e

Ministres Vlora Çitaku që po punon shumë për këtë proces. Ashtu siç ka thënë ajo aspekti teknik është përmbushur dhe tani ne presim vetëm marrjen e udhërrëfyesit për liberalizimin e vizave.

Suzana Novobërdali – tha se vërejti qëndrimet pro dhe kundër të cilat i respekton meqë sigurisht keni edhe arsyet e juaja, dhe se qëndrimi i atyre që janë kundër do të ndryshojë me kohë sepse ne duam ta arsyetojmë prezencën tonë në BE meqë është një rrugë e gjatë. Mbikëqyrja e ndërkombëtarëve në Kosovë fillimisht është pranuar me shumë pozitivitet nga të rinjtë dhe të gjithë. Është pritur më shumë nga ta deri sa kanë dështuar, ku si shembull është EULEX-i për të cilin tani mund të them se në Kosovë ka një qasje më ndryshe ndaj punës së tyre.

Gerda Verburg - Kryetarja e Komisionit Holandez për Çështje Evropiane në fund theksoi se çështja kryesore është që ju si komision dhe deputetë të Kuvendit jeni duke ndërtuar një sistem parlamentarë demokratik që u jep shpresë të gjitha gjeneratave, perspektivë për siguri dhe udhëtim kudo në botë. Kjo sigurisht që kërkon edhe përgjegjësi, dhe duke ju falënderuar për diskutimin ju uroj suksese në punën tuaj.

Kryesuesi falënderoi anëtarët e komisionit holandez dhe ambasadorin holandez në Kosovë për mbështetjen e madhe dhënë Kosovës. Ne do të përpiqemi të punojmë më shumë dhe të jemi shembull për të rinjtë, dhe si komision jemi të interesuar të shpijmë këto procese sa më përpara.

Takimi përfundoi në orën 11:15.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Kryetari i Komisionit

Lutfi Haziri